



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

## **FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË TRYEZËN E “FORUMIT CIVIL 2010”**

*31 tetor 2012*

President Moisiu,  
President Meidani,  
Zonja dhe zotërinj,

Pjesëmarrja në një veprimtari të “Forumit Civil 2010” është shumë domethënëse për mua. Jam i gëzuar që jam sërish me ju këtë mëngjes.

Sot, do të diskutojmë për një temë kyçe për stabilitetin dhe prosperitetin e këtij vendi: krimi në Shqipëri.

Të gjithë e dimë se tranzicioni drejt demokracisë në Shqipëri solli ndryshime dramatike në kontekstin kombëtar, brenda një kohe shumë të shkurtër. Për fat të keq, kjo i dha mundësi edhe krimit që të zhvillohej shumë shpejt e të vendoste lidhje me krimin e organizuar ndërkombëtar, një sfidë serioze për sigurinë.

Shkalla e lartë e krimit të organizuar, apo e perceptuar si e tillë, e ka dëmtuar reputacionin e Shqipërisë, ndërkohë që trazirat e tmerrshme të vitit 1997 lejuan që një numër i madh armësh të binin në duart e kriminelëve.

Megjithatë, reforma e sektorit të sigurisë eci me hap të ngadaltë. Për këtë arsye, ishte e vështirë që krimi të luftohej me më shumë efikasitet. U deshën përpjekje domethënëse të autoriteteve vendore, organeve të zbatimit të ligjit dhe partnerëve ndërkombëtarë për stabilizimin e situatës dhe për ngritjen e kapacitetit të shtetit për të luftuar krimin.

Zonja dhe zotërinj,

Unë jam i sigurt se cilido në këtë sallë është dakord se siguria nuk është një çështje abstrakte. Disa mund të mos e ndiejnë kur ajo ekziston, por e ndiejnë patjetër kur ajo mungon.

Siguria lidhet me legjitimitetin e shteteve demokratike moderne: të drejtën bazë për siguri dhe detyrimin e institucioneve shtetërore për ta garantuar atë. Siguria lidhet me të drejtat e njeriut.

Ne po flasim për një parim kushtetues dhe për një konsensus ndërkombëtar në rritje, të reflektuar në dokumente të ndryshme të OKB-së, duke i detyruar shtetet që ta mbrojnë lirinë e çdo individi kundrejt frikës.

Krimi dhe ekzistenca e grupeve kriminale cenojnë autoritetin e shtetit dhe shtetin e së drejtës, duke ndikuar negativisht në cilësinë e jetës së qytetarëve dhe duke i gërryer shoqëritë nga brenda.

Nuk mund të ketë as shoqëri të lirë dhe të hapur pa siguri dhe as zhvillim.

Rreth 20 vjet më parë, gjatë periudhës komuniste, Policia përdorej si mjet shtypjeje. Për pjesën më të madhe të qytetarëve, bashkëpunimi me Policinë nuk përbënte një opsion. Ajo i bënte

njerëzit të ndiheshin të pasigurt, që është pikërisht ajo që nuk duhet të ndodhë kurrë: në demokraci, përfshirë Shqipërinë, policia ekziston për t'u ofruar një shërbim qytetarëve.

Reforma në sektorin e sigurisë është një proces i gjatë dhe kompleks. Për të qenë e suksesshme, ajo duhet të jetë edhe gjithëpërfshirëse.

Përmirësimi i kapaciteteve të organeve të zbatimit të ligjit është thelbësor, duke përfshirë edhe standardet e trajnimit. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri i ka mbështetur vazhdimisht përpjekjet për këtë qëllim, duke i ofruar gjithashtu asistencë Policisë së Shtetit Shqiptar për të ruajtur standardet e larta dhe profesionalizmin.

Ka ende shumë për të bërë.

Në këtë kontekst, korrupsioni mbetet kërcënim i madh ndaj shtetit të së drejtës dhe institucioneve demokratike në Shqipëri. Pandëshkueshmëria nuk mund të pranohet kur shkelet ligji.

Ligjet e reja për Policinë e Shtetit, ligji Anti-Mafia dhe miratimi kohët e fundit i mundësisë për të hequr imunitetin e zyrtarëve të lartë, janë shembuj të mirë përparimi në këtë drejtim.

Megjithatë, këto duhen shoqëruar me një bilanc bindës vendimesh dhe dënimesh apo gjobash të rrepta e të përshtatshme në të gjitha rastet e korrupsionit.

President Moisiu,  
President Meidani,  
Zonja dhe zotërinj,

Meqenëse ky rreth është në fakt një Forum i vërtetë Civil, do të doja të theksoja se të gjithë aktorët, autoritetet dhe qytetarët kanë interes të përbashkët në luftën kundër krimit.

Agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të punojnë së bashku me qytetarët dhe komunitetet për të parandaluar të gjitha format e krimit. Instrumentet policore, si policimi në komunitet, kanë rezultuar shumë të dobishme në parandalimin e krimit dhe në rritjen e besimit të publikut te policia. Nisma të tilla duhen çuar më tej.

Më lejoni t'ju përgëzoj për këtë diskutim të një niveli të lartë që do të zhvillohet këtu.

Faleminderit!

**Fund**